



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

 MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË

Nr 1858/1 prot

Dt 07.12.20

AKT-MIRATIMI

ORGAN I MIRATUARI VLERËSIM KONFORMITETIT.

Mbështetur në Kreun V të ligjit Nr. 10489, datë 15.12.2011 "Për tregti min dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore" i ndryshuar, Urdhri e Ministrit Nr. 53 datë 05.10.2017 "Për miratimin e rregullores "Për procedurat e miratimit dhe mbikëqyrjes së organeve evropiane të notifikuara dhe organeve të miratuara të vlerësimit të konformitetit" edhe në Certifikatën e Akreditimit me Nr. **TI 030** Regjistrimi. Rish. 2.

MIRAT O J:

Subjekti:	"TECH-INSPECT" sh.p.k
Me Administrator:	Sention ZOTAJ
Me Drejtues Teknik:	Nevrus PODA; Franc LAMI; Arben TARE
Adresa e subjektit:	Rruga "Shyqyri Brari", pranë Kopshtit Zoologjik, Nd2/1, Tiranë.
Tel.:	-
Cel.:	067 20 16 333
E-mail:	sention.zotaj@techinspect.al

të ushtrijë veprimtarinë si Organ i Miratuar i Vlerësimit të Konformitetit (OMVK):

Tipi i OMVK-së:	Tipi A
Fusha e Veprimtarisë:	I-Inspektimi i pajisjeve ngritëse industriale: - Vinça portuale; - Vinca të lëvizshëm - Vinça urë dhe me krah; - Vinç pedestal ofshore; - Pajisje ngritëse elektrike me zinxhir; - Pajisje ngritëse elektrike; - Pajisje ngritëse elektrike me kavo; - Pajisje ngritëse me operim manual; - Pajisje ngritëse hidraulike; - Vinç portabël hidraulik; - Vinç flamur; - Pajisje për tërheqje dhe ngritje me kavo.

- Kanteniere ofshorë dhe të thjeshtë
 - Pajisje ngritëse dhe platforma të lëvizshme për ngritjen e njerëzve.
- 2- Inspektimi i aksesorëve të përdorura në pajisjet ngritëse:**
- Pajisje e fiksimit të kavos;
 - Aksesor ngritës lëkundës;
 - Aksesor ngritës në formë trau;
 - Bllok me pulexho dhe ganxhë;
 - Tirant me vidë;
 - Bllok me pulexho;
 - Aksesor për ngritjen e pllakave metalike;
 - Aksesor ngritës hallke;
 - Pajisje ngritëse e varur në tra/shine.
- 3- Inspektimi i makinerive.**
- (Sipas përcaktimeve në pikat 14.2.2; 14.3.4 dhe 24.1 të VKM 1060, datë 23.12.2015).
- 4- Inspektimi i enëve, pajisjeve dhe instalimeve nën presion:**
- Enë të thjeshta nën presion;
 - Instalime nën presion;
 - Tubacione nën presion;
 - Enë kriogjenike
 - Koka pusi.
- 5- Inspektimi i rezervuarëve GLN me kapacitet më të vogël ose baraz me 13 m³.**
- 6- Inspektimi i rezervuarëve GLN me kapacitet më të madh se 13 m³.**
- 7- Inspektimi i kaldajave të avullit dhe ujit të nxehtë.**
- 8- Inspektimi i rezervuarëve mbitorësorë të hidrokarbureve të lëngët.**
- 9- Inspektimi i enëve të transportueshme nën presion;**
- 10- Inspektimi i pajisjeve dhe instalimeve elektrike:**
- Matja e fushës elektro magnetike në pajisje dhe instalime elektrike;
 - Matja e rezistencës së tokëzimit të pajisjeve dhe instalimeve;
 - Inspektimi i gjendjes së izolatorëve;
 - Inspektimi i rezistencës së izolimit të instalimeve dhe pajisjeve elektrike;
 - Inspektim i mbrojtjes katodike për strukturat metalike të instaluar në sipërfaqen e tokës.
- 11- Inspektimi i linjave të tensionit të lartë:**
- Matja e fushës elektrike e magnetike në linjat e tensionit të lartë;
 - Matja e rezistencës së tokëzimit;
 - Matja e vertikalishtet të shtyllave;
 - Inspektimi i gjendjes së izolatorëve;
- 12- Inspektimi i nënstacioneve elektrike:**
- Matje e fushës elektrike magnetike
 - Matje e rezistencës së tokëzimit;
 - Inspektim i gjendjes së izolatorëve;
- 13- Inspektimi i kabinave elektrike TU/TL.**
- 14- Inspektimi i instalimeve elektrike në zona potencialisht shpërthyes (ATEX – Explosive Atmospheres).**

	15- Vlerësimi i konformitetit të projekteve teknike dhe teknologjike për produktet/pajisjet/instalimet nën presion, të përshkruara në pikat 4-8, të cituara më sipër. 16- Lëshim Vërtetimi Teknik për subjektet që kryejnë aktivitet në fushën e transportit dhe tregtimit të gazit, naftës dhe nënprodukteve të tyre.
Rregullat teknike/standartet e sigurisë së produktit/pajisjes/instalimit të vënë në shërbim:	1. Ligji nr.10489,datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”. 2. Ligji nr. 8734, datë 1.02.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike”. 3. Ligji nr. 32/2016 datë 24.03.2016 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nën presion”. 4. VKM nr. 430, datë 26.6.2019 “ Për miratimin e rregullit teknik për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve të transportueshme nën presion”. 5. VKM nr. 1060, datë 23.12.2015, “Për miratimin e rregullit teknik “Për makineritë””. 6. Urdhër nr.184, datë 5.7.2005 “Për miratimin e kushteve teknike dhe normave teknike për impiantet dhe instalimet që shërbejnë për depozitimin dhe trajtimin e naftës dhe gazit”. 7. SSH EN 62110:2009 – Nivelet e fushës elektrike e magnetike të gjeneruara nga sistemet e fuqisë të rrymës alternative. 8. SSH EN 61786-1:2014 – Matja e fushave elektrike e magnetike me frekuencë të ulët të lidhur me ekspozimin e qënieve njerëzore Kërkesa specifike për instrumentet dhe udhëzimet për matje. 9. Udhëzimi ICNIRP – Për limitimin e ekspozimit ndaj fushës elektrike, magnetike dhe elektromagnetike që ndryshojnë me kohën. 10. IEEE Std 81-2012 – Udhëzime për matjen e përcjellshmërisë së tokës, rezistencës së tokëzimit dhe potencialit të tokës. 11. KTP 18-78 – Kushtet teknike të projektimit. 12. SSH EN 62271-102:2002+A2:2013– Ndarësit e tensionit të lartë në fushat e nënstacioneve. 13. SSH EN 60076-1:2011– Transformatorët e fuqisë. Të përgjithshme. 14. CIRED – Konferenca e 21 ndërkombëtare mbi Shpërndarjen e Energjisë. 15. SSH EN 280:2013+ A 1:2015 “Platformat e lëvizshme për ngritjen e njerëzve. Llogaritje në projektim. Kriteret e qëndrueshmërisë. Konstruksioni. Siguria, Ekzaminime dhe testime”.
Periudha e vlefshmërisë:	Deri më 05.03.2022
Territori i ushtrimit të veprimtarisë:	Në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
Personi përgjegjës firmosës:	Sention ZOTAJ; Nevrus PODA; Franc LAMI; Arben TARE
Nr. Telefoni:	0672016333; 0697520781; 0699494343
E-mail:	sention.zotaj@techinspect.al nevrus.poda@techinspect.al

OMVK regjistrohet me
Nr. Identifikimi:

OMI 0 1 6 R 3

OMVK detyrohet të plotësojë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, kërkesat dhe kushtet sa më poshtë:

1. Është përgjegjës për veprimtaritë e vlerësimit të konformitetit, të kryera sipas objektit të tij të miratimit dhe çdo veprimtari tjetër të kryer, përfshirë veprimtaritë nënkontraktuese.
2. Nuk duhet të përfshihet në veprimtaritë që mund të krijojnë konflikt me pavarësinë/paanësinë e tij të gjykimit ose integritetin për aktivitetet e vlerësimit të konformitetit, për të cilat ai është miratuar;
3. Siguron se veprimtaritë e degëve ose nënkontraktorëve të tij nuk prekin/ndikojnë në konfidencialitetin, objektivitetin, paanësinë e veprimtarive të tij të vlerësimit të konformitetit;
4. I siguron Ministrin, Strukturës Administrative Përgjegjëse (SAP), brenda 10 ditësh, kopje të certifikatave, raporteve të testeve dhe të vlerësimit të konformitetit, përfshirë dokumentet për to dhe informacionin për lëshimin, refuzimin ose tërheqjen e certifikatave për çdo subjekt;
5. Detyrohet të informojë Ministrin pa vonesë për çdo rast, në të cilin ky organ bëhet i paafët të sigurojë përmbushjen e kushteve të vendosura për ushtrimin e miratimit të vlefshmërisë së konformitetit;
6. Informon brenda 5 ditësh Ministrin (SAP) për çdo refuzim, kufizim, pezullim ose tërheqje certifikate;
7. Informon Ministrin për çdo kërkesë për informacion, të cilën ai ka marrë nga Inspektorati Shtetëror në varësi të MIE-s, për veprimtarinë e vlerësimit të konformitetit;
8. Detyrohet të mbajë regjistra të plotësuar rregullisht të të gjitha procedurave të vlerësimit të konformitetit, për të cilat ai është miratuar dhe të rezultateve të tyre për jo më pak se 10 vjet.
9. Me kërkesë të ministrit përgjegjës detyrohet të marrë pjesë në testime ose krahasime të tjera të përcaktuara për OMVK-të.
10. Në fund të çdo periudhe katërmujore, detyrohet të dërgojë Ministrin (SAP) regjistrin e inspektimeve ose certifikatave të lëshuara për periudhën në fjalë.
11. Organi i Miratuar detyrohet t'u krijojë akses të plotë punonjësve të SAP, të pajisur me urdhër të Ministrin, që të evidentojnë të gjitha të dhënat për përmbushjen e kërkesave të vlerësimit të konformitetit dhe të hyjnë në të gjitha ambientet ku OMVK ka kryer vlerësimi të konformitetit, të përcaktuar në miratimin e lëshuar.

Në rast të konstatimit të mos plotësimit të kërkesave dhe kushteve sipas pikave 2, 3, 4, 5, 6, 8, 9, 10, 11, ose në rast se organi i miratuar nuk arrin të përmbushë më një apo disa kritere a kërkesa të përcaktuara në rregullat teknike përkatëse apo në rregullat për sigurinë e produktit/instalimit të vendosur në shërbim/në përdorim dhe kushtet e përcaktuara në aktin e miratimit, SAP i propozon Ministrin pezullimin e Aktit të Miratimit deri në afatin e dhënë për plotësimin e tyre.

Nëse Organi i Miratuar dështon në plotësimin e kushteve dhe kërkesave sa më sipër brenda afatit të caktuar, SAP përgatit dhe i paraqet për firmë Ministrin urdhërin për shfuqizimin e Aktit të Miratimit dhe heqjen e emrit të OMVK nga regjistri i organeve të miratuara.

Datë: 07 / 12 / 2020

MINISTRI

Belinda Balluku

